



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Raport i Diskutimit Publik për Draft Planin Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale

Komuna e Podujevës ka marrë vendim për iniciimin e procedurave të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale, me 28 dhjetor 2023.

Grupi i Operatorëve Ekonomik FST Engineering SH.P.K.; AL Engineering SH.P.K.; Enggroup SH.P.K., Prishtinë së bashku me grupin menaxhues së Komunës së Podujevës ka përgatitur Draftin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale. Ky dokument paraqet zhvillimin e qëndrueshëm për Komunën e Podujevës. Kjo zonë industriale e planifikuar mirë do të siguroj hapësira të mjaftueshme për operime në kushte optimale duke qenë bazë e informatave, rregullave dhe kushteve për rregullimin e lagjes.

Ky Draft Plan Rregullues i Hollësishëm për Zonën Industriale synon të kontriboj në nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Republikën e Kosovës, zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës, aftësim profesional, përqëndrimin e bizneseve në një vend të caktuar, zgjerimin e bashkëpunimit mes bizneseve, furnizimin me ujë, energji dhe shërbime në mbështetje të bizneseve, si dhe nxitjen e rritjes së konkurrencës në bizneset vendore.

Draft Plani Rregullues i Hollësishëm për Zonën Industriale është përgatitur dhe proceduar në Kuvend më datë 04 mars 2024, hapja zyrtare e shqyrtimit publik është mbajtur me dt: 22.03.2024 në ora 15:18-15:48 (është mbajtur proces verbal), konsultimi fillestar publik është mbajtur me dt: 26.03.2024 në ora 10:30-11:15(është mbajtur proces verbal).

Në takimin e datës 22.03.2024 në bashkëbisedim ndërmjet drejtorit dhe qytetarëve u parashtruan pyetjet si: Sa hyrje do të ketë Zona Industriale dhe si do të planifikohet sipërfaqja për industrinë e lehtë? Drejtori u përgjigj se do të ketë tri hyrje momentale, ndërsa znj. Valesa Jahmurati tha se për industrinë e lehtë janë planifikuar sipërfaqet me përmasa 2500m²-10.000m². Nga ky takim nuk kishte propozime për t'u përfshirë në këtë draft projekt, por u parashtruan vetëm pyetje informuese.

Në takimin e datës 26.03.2024, u diskutua vetëm çështja e shpronimit të pronave, gjë që nuk ishte tema për të cilën ishte thirrur takimi me qytetarë. Po ashtu edhe në këtë takim nuk kishte propozime me përmbajtje për t'u përfshirë në plan.

Shqyrtimi publik i Projekt Dokumentit ka zgjatë 30 ditë përkatësisht prej datës 22 mars 2024, deri më datë 22 prill 2024, sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Brenda kësaj periudhe kohore propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet, kanë pasur mundësinë që të paraqiten me shkrim në

librin e vërejtjeve, si dhe në formë elektronike në e-mail adresat; blerina.zeka@rks-gov.net dhe info.podujeva@rk-gov.net.

Mirëpo, edhe pse janë bërë njoftimet për t'i paraqitur propozimet, vërejtjet apo sqarimet, përgjatë periudhës së shqyrtimi publik të Projekt Dokumentit nuk është pranuar asnjë vërejtje, sugjerim apo propozim qoftë në formë fizike apo edhe në atë elektronike.

Bashkëngjitur në këtë raport gjeni:

1. Vendimin për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës
 - <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2023/12/Thirrja-e-mbl.-Kuv.-28.12.2023.pdf>
2. Vendimi për vënie në shqyrtim publik të Prokjekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës
 - <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/04/1.Vendim-per-Shqyrtim-Publik-PRRH-per-Zonen-Industriale.pdf>
3. Njoftimit për diskutim publik:
 - <https://kk.rks-gov.net/podujeve/?newsctpt=njoftim-vendim-per-venie-ne-shqyrtim-publik-te-projekt-dokumentit-te-planit-rregullues-te-hollesishem-per-zonen-industriale-ne-komunen-e-podujeves>
 - <https://www.facebook.com/KomunaEPodujeves/posts/pfbid03pbVqayv7o3pLV1TPY76qLk5CdWjNYUmDG26g1QcQ2Ad1Xz7S2NT4q4pYksFfvi2l>
4. Materiali i draft Planit Rregullues të Hollësishëm Të Zonës Industriale:
 - https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/03/Pjesa-Tekstuale_Pershkrimi-teknik-dhe-paramasa.pdf
 - https://kk.rks-gov.net/podujeve/?page_id=200043017
5. Procesverbalin e hapjes zyrtare të shqyrtimit publik dhe listën e pjesëmarrësve të datës 22.03.2024;
6. Procesverbalin e konsultimit fillestar publik dhe fotografitë e pjesëmarrësve të datës 26.03.2024;

Podujevë, datë **26.04.2024**

Raportin e përgatiti

Blerina Zeka





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), nenet 17 dhe 40 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 10 paragrafi 2.1 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr.04/L-174, Udhëzimit Administrativ MMPH nr.01/2018 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, nenet 14, 15 paragrafi 2.4; nenet 19 dhe 34 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2023, miratoi këtë;

V E N D I M PËR INICIMIN E PROCEDURAVE PËR HARTIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM

Neni 1

Me këtë vendim lejohet iniciimi i procedurave për hartimin e **Planit Rregullues të Hollësishëm për "Zonën Industriale"** në Komunën e Podujevës, duke përfshirë parcelat me nr. 00752-10; 00752-9; 00752-8; 00752-6; 00752-7; 00752-2; 00752-1; 02935-3; 02935-1; 02935-2; 02935-5; 02935-6; 02935-7; 02935-8; 02935-9; 00754-2; 00753-2; 00755-0; 02998-1; 02998-2 - Zona kadastrale Podujevë, si dhe parcelat me nr. 00225-0; 00228-0; 00238-0; 00235-0; 00241-0; 00245-0; 00266-0; 00198-0; 00193-0; 00188-0; 00210-0; 00208-0; 00206-0; 00207-0; 00203-0; 00201-0; 00204-0; 00200-0; 00205-0; 00199-0; 00197-0; 00222-0; 00209-0; 00267-0; 00196-0; 00202-0; 00221-0; 00220-0; 00265-1; 00265-2; 00219-0; 00227-0; 00218-1; 00218-4; 00218-5; 00211-0; 00212-8; 00212-2; 00212-1; 00212-7; 00212-6; 00212-5; 00212-4; 00212-3; 00503-1; 00503-2; 00488-0; 00229-2; 00229-3; 00230-2; 00230-3; 00230-4; 00500-3; 00500-4; 00500-5; 00500-6; 00500-9; 00218-6; 00226-2; 00226-1; 00223-2; 00223-1; 00224-2; 00224-1; 00292-0; 00293-1; 00293-2; 00293-3; 00509-0; 00510-0; 00190-0; 00192-0; 00191-0; 00500-7; 00500-12; 00500-13; 00500-10 - Zona Kadastrale Livadicë, me sipërfaqe të përgjithshme 613961.51 m², sipas Hartës Zonale të Komunës.

Neni 2

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave urbane apo zona rurale siq është e përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal për periudhën 2016 - 2025 si dhe Hartën Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2022 - 2030.

Neni 3

Bartës i procesit të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për "Zonën Industriale", është Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si Autoritet përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, në koordinim dhe bashkëpunim me Drejtoritë sektoriale brenda Komunës së Podujevës.

Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm për “Zonën Industriale” do të mbulon periudhën të paktën 8 (tetë) vite.

Neni 5

Pjesë përbërëse të këtij vendimi sipas nenit 1 janë Certifikatat pronësore dhe Kopjet e Planit.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 dit pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot; 01-016/01-0090910/23
Podujevë, datë; 28 dhjetor 2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja d) nenin 17 dhe nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 11 paragrafi 1.15; 17 paragrafi 5; neneve 20 dhe 26 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin hapësinor, nenit 4 paragrafi 3.3; 7 paragrafi 2; neneve 8; 10 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, Udhëzimin Administrativ MMPH nr.01/18 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimin Administrativ MMPH nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për administratë të hapur në komunë, si dhe neneve 14, 15, 34.2 dhe nenin 64 paragrafi 2.5 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 mars 2024, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR VËNIE NË SHQYRTIM PUBLIK TË PROJEKT DOKUMENTIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR ZONËN INDUSTRIALE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

1. Me këtë vendim vëhet në shqyrtim publik Projekt Dokumenti i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Zonat Kadastrale Podujevë dhe Livadicë - Komuna e Podujevës
2. Projekt dokumenti nga 1 i këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Pjesëmarrja dhe shqyrtimi publik

1. Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale sipas këtij vendimi, bëhet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit më **22.03.2024, në ora 14:00**. Konsultimi fillestar publik caktohet të mbahet më **26.03.2024** nga ora **10:00** në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

2. Shqyrtimi publik i Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale, zgjat 30 ditë përkatësisht nga data **22.03.2024 deri më 22.04.2024** sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

3. Shpallja e shqyrtimit publik të Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale sipas këtij vendimi, bëhet tetë (8) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, përkatësisht në ueb faqe të Komunës.

4. Projekt Dokumenti i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/> (Rubrika; Aktet për diskutim publik) si dhe në Platformën Qendrore të Konsultimeve Publike <https://konsultimet.rks-gov.net>

5. Projekt Dokumenti i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

6. Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku gjatë diskutimeve me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresave elektronike; blerina.zeka@rks-gov.net dhe info.podujeva@rks-gov.net brenda afatit kohor, përfshihen në Raportin mbi shqyrtimin publik.

7. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, Projekt Dokumenti i cekur së bashku me një përmbledhje të shkurtë të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik dhe raportin përkatës do të dorëzohen Kuvendit të Komunës së Podujevës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 3

Subjekti përgjegjës

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si Autoritet për planifikim hapësinor, është përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi në bashkërendim dhe bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse sektoriale përgjegjëse.

Neni 4

Kufiri i territorit

Zona Industriale për të cilën është hartuar Projekt Dokumenti i Planit Rregullues i Hollësishëm përfshinë një sipërfaqe prej 613911 m². Parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë shtrihen në kuadër të Zonave Kadastrale Podujevë dhe Livadicë.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-944/01-0015793/24
Podujevë, datë; 04 mars 2024





A

A

NJOFTIM: Vendim për vënie në shqyrtim publik të Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës

2024/03/13 - 1:43

Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale sipas këtij vendimi, bëhet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit më 22.03.2024, në ora 14:00. Konsultimi fillestar publik caktohet të mbahet më 26.03.2024 nga ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

Shqyrtimi publik i Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale, zgjat 30 ditë përkatësisht nga data 22.03.2024 deri më 22.04.2024 sipas procedurave të përcaktuara me ligj.



Republika e Kosovës, Republika Kosovo, Republic of Kosovo
Komuna e Komunës e Podujevës, Municipality of Podujeva

RYAFTET KOUJUNE

Mirëdita! Kjo është lista e dokumenteve të publikuara nga Komuna e Komunës e Podujevës në ditën e sotme. Dokumentet janë të disponueshme në faqen tonë elektronike në internet dhe mund të shikohen në adresën: www.komuna-podujeva.gov.net. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutem kontaktoni zyrtarin për informim të Komunitetit në adresën: info@komuna-podujeva.gov.net ose në numrin e telefonit: 042 310 1000.

**1. NENI 103
STATUTI I KOMUNES E PODUJEVES NE KOSOVE**

**Neni 1
Eja zakonet e planifikimit hapësinor**
1. Miratimi i planit hapësinor të Komunës së Podujevës është kompetencë e Komunitetit të Komunës së Podujevës.

**Neni 2
Hijerarkia e planit hapësinor**
1. Eja zakonet e planifikimit hapësinor të Komunës së Podujevës janë të lidhura hierarkisht dhe ndjekin të njëjtën strukturë të planifikimit hapësinor.

2. Dokumentet e Planit Hapësinor të Komunës së Podujevës janë të disponueshme në faqen tonë elektronike në internet në adresën: www.komuna-podujeva.gov.net.
3. Dokumentet e Planit Hapësinor të Komunës së Podujevës janë të disponueshme në faqen tonë elektronike në internet në adresën: www.komuna-podujeva.gov.net.
4. Dokumentet e Planit Hapësinor të Komunës së Podujevës janë të disponueshme në faqen tonë elektronike në internet në adresën: www.komuna-podujeva.gov.net.
5. Dokumentet e Planit Hapësinor të Komunës së Podujevës janë të disponueshme në faqen tonë elektronike në internet në adresën: www.komuna-podujeva.gov.net.
6. Dokumentet e Planit Hapësinor të Komunës së Podujevës janë të disponueshme në faqen tonë elektronike në internet në adresën: www.komuna-podujeva.gov.net.
7. Dokumentet e Planit Hapësinor të Komunës së Podujevës janë të disponueshme në faqen tonë elektronike në internet në adresën: www.komuna-podujeva.gov.net.
8. Dokumentet e Planit Hapësinor të Komunës së Podujevës janë të disponueshme në faqen tonë elektronike në internet në adresën: www.komuna-podujeva.gov.net.

KOMUNITETI I KOMUNES E PODUJEVES
Adresa: Rruga "Nuhi Gashi", Kodi Postar: 11000, Podujevë.
Telefon: 042 310 1000. E-mail: info@komuna-podujeva.gov.net



ADRESA

Rruga "Nuhi Gashi"

Kodi Postal: 11000

Podujevë

KONTAKTI

038-200 41018

EMAIL: infopodujeva@rks-gov.net

VEGEZA

Lidhjet në WEB me Komunat e Kosovës (<https://kk.rks-gov.net/>)

Platforma e konsultimeve publike (<https://konsultimet.rks-gov.net/>)

Portali i konkurseve për punësim (<https://konkursi.rks-gov.net/>)

eKosova-Platforma e shërbimeve online (<https://ekosova.rks-gov.net/>)

FAQET

Podujeve (<https://kk.rks-gov.net/podujeve/>)

Komuna (https://kk.rks-gov.net/podujeve/?page_id=200000000)

Kryetari (https://kk.rks-gov.net/podujeve/?page_id=200000000)

- Shpejtim Bulliqi (<https://kk.rks-gov.net/podujeve/?staffcpt=shpejtim-bulliqi>)
- Nënkryetarja (<https://kk.rks-gov.net/podujeve/?staffcpt=marigona-lahu>)
- Vendimet Kryetarit (https://kk.rks-gov.net/podujeve/?document_category=vendimet-al)
- Kabineti (https://kk.rks-gov.net/podujeve/?page_id=200000009)



1



Komuna e Podujevës updated their status.



March 13 · 🌐

NJOFTIM: Vendim për vënie në shqyrtim publik të Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës.

Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale sipas këtij vendimi, bëhet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit më 22.03.2024, në ora 14:00. Konsultimi fillestar publik caktohet të mbahet më 26.03.2024 nga ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

Shqyrtimi publik i Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale, zgjat 30 ditë përkatësisht nga data 22.03.2024 deri më 22.04.2024 sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

13.03.2024, Podujevë

Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim

16

Like

Comment

Share



Write a comment...





DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Procesverbal

Konsultimi fillestar publik për Projekt Dokumentin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale me qytetarë i mbajtur më 26/03/2024

Takimi filloi në orën 10:30, në sallën nr.52.

Takimin e hapi dhe e kryesoi **z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.**

Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (rreth 9 - bashkëngjitur foto e pjesëmarrësve) dhe zyrtarë komunal.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e hapi takimin duke përshëndetur të pranishmit dhe duke ju dëshiruar mirëseardhje, ndër të tjera theksoi arsyen për mbajtjen e këtij debati publik.

Ashtu siç edhe jeni të informuar, në këtë takim si temë është paraparë:

➤ **Plani Rregullues i Hollësishëm për Zonën Industriale.**

Të nderuar të pranishëm prezentimi i draft Planit Rregullues të Hollësishëm është bërë me datën 22.03.2024, prandaj pa humbur kohë po fillojmë me pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e juaja.

Urdhëroni, fjala për ju.

z. Rifat Ferizi, përfaqësues ligjor i Xhemajl Arfit, theksoi;

-Në lidhje me disa prona në Zonën Kadastrale - Livadicë ka një aktgjykim i Gjykatës Komunale i cili nuk është ekzekutuar në kadastrin e Podujevës.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sqaroi;

-Për këtë çështje nuk është kompetent dhe se një përgjigje të saktë do të mund ta merrnin nga Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

z. Rifat Ferizi, përfaqësues ligjor i Xhemajl Arfit, vazhdoi si në vijim;

- Ekzekutivi i vendimeve gjyqësore është duke zhvilluar procedura penale në Prokurorinë Thelore të Prishtinës, në procedurë administrative është ankimi vendimi i Qeverisë për këto parcela, për shpronësim në dhomë të posaçme të Gjykatës Supreme është ankimi çështja e të drejtës së përkthimit të pronave bartjes te Qeveria.

-Një hartë me koncepte kish qenë mirë me kriju!

Ndërpreje

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sqarim parafolësit, theksoi;

- Përmes Drejtorisë së Pronës, Kadastrit të Gjeodezisë më njoftuan se procedurat duhet t'i zhvillojë përmes gjykatës, pastaj gjykata jep vendimin për çdo gjë që është kontestuese.

z. Rifat Ferizi, përfaqësues ligjor i Xhemajl Arfit;

- Pronat janë të ndara në publike, private dhe ato të kontestuara, pronat tona janë të paraqitura si publike. Unë jam këtu për pasqyrim të gjendjes faktike jo të drejtë.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sqaroi;

- Në diskutimin aktual mund të flasim për Planin Rregullues dhe se qytetarët mund të vazhdojnë me ankesat në lidhje me parcelat publike në organet kompetente, ndërsa theksoi se për këtë çështje do të duhej të merrnin pjesë në debatin publik i cili ishte për këtë arsye. Debat ky i cili ka qenë i shpallur në faqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

z. Veli Hasani, shtoi;

- Tokat tona janë paraqitur si prona publike, askush nuk na ka informuar në lidhje me këtë plan dhe për planifikimin e këtyre ndërtimeve.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi;

- Nëse Komuna interesohet për këto prona atëherë do të bëhet shpronësimi i tyre dhe qytetarët do të paguhet për çdo m². Në asnjë pronë private nuk do të ndërhyjë Komuna pa filluar procesin e shpronësimit.

Takimi përfundoi në ora 11:15

Procesverbalin e mbajti,

Blerina Zeka

Podujevë,

26/03/2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debat publik me qytetarë, për vënienë në shqyrtim publik të Projekt Dokumentit të Planit
Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës / 22.03.2024

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	ARTON RAJTAZI	Podujevë		
2	Avni Zeyiri	Podujevë		
3	Jehona Agushi	Podujevë		
4	Hammide Bahitiri	Gllanmik		
5	Teuta Prähmani	Dumnica		
6	Diellza Rama	Podujevë		
7	Genç Gashi	Podujevë		
8	LIRIDONA PRAHMANI	PODUEVË		
9	Shqipdon Rushiti	Podujevë		
10	FIDAN RESTELICA	PODUEVË		
11	FATON TURKAT	PRISHTINË		
12	VALERA JANUJARI	PRISHTINË		
13	BLERINA ZEKA	PODUEVË		
14	Donjeta Fazliu	Podujevë		
15	BESHNIK MURATI	Podujevë		
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				

24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				

Podujevě

22.03.2024



DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Procesverbal

Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale me qytetarë i mbajtur më 22/03/2024

Takimi filloi në orën 15:18, në sallën e Kuvendit Komunal.

Takimin e hapi dhe e kryesoi z. **Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.**

Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (rreth 15 - bashkëngjitur lista e pjesëmarrësve), përfaqësues të kompanisë projektuese (Operatori Ekonomik) dhe zyrtarë komunal.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e hapi takimin duke përshëndetur të pranishmit dhe duke ju dëshiruar mirëseardhje, ndër të tjera theksoi arsyen për mbajtjen e këtij takimi.

Ashtu siç edhe jeni të informuar, në këtë takim si temë është paraparë:

➤ **Plani Rregullues i Hollësishëm për Zonën Industriale.**

Të nderuar të pranishëm sipas Vendimit për vënie në shqyrtim publik të Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës lidhur me zhvillimin e këtij projekti, hapjen e debatit publik po e realizojmë sot dhe ju falënderoj të gjithëve për kohën tuaj.

Më lejoni që fjalën të ia kaloj përfaqësueses së kompanisë projektuese që të prezantoj draft Planin Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale, pastaj do ta hapet debati nga i cili do të marrim me seriozitet vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe rekomandimet tuaja në mënyrë që ta miratojmë formën më të mirë të Planit Rregullues për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës.

Urdhëroni, fjala për ju.

znj. Valesa Jahmurati, filloi prenazntimin;

-Sipërfaqja e planit rregullues së Zonës Industriale përfshin një sipërfaqe prej 61.7 ha, ka një pozitë të volitshme gjeografike në raport me qytetin, fshatrat dhe vendet përreth. Rrjeti rrugor është i varfër, përveç rrugës kresore. Rrjeti rrugor i propozuar është bërë për të ofruar zgjedhje. Pjesa me ngjyrë të verdhë paraqet pronën publike të Komunës, pjesa me ngjyrë të portokalltë paraqet parcelat që janë në kontest gjyqësor dhe parcelat me ngjyrë kafe janë pronë private. Plani i parcelimit: hapësirat gjelbëruese, zona e gjelbërti i dedikohet gjelbërimit, pjesa me të verdhë qendër rekreative. Zona është ndarë në : publike, private dhe në kontest gjyqësor. Veprimtaritë që janë planifikuar për këtë zonë i takojnë llojeve: prodhime industriale (industri e lehtë, e industri e rëndë/e lëndës së parë dhe industri e lehtë/ e rëndë), servise, gastronomi,

prodhime zejtare, shkollë profesionale, shërbime plotësuese dhe qendër sportive dhe rekreative. Pra, ky është draft projekti jonë për Zonën Industriale.

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, merr fjalën;

-Falenderon kompaninë projektuese për prezentimin e këtij plan dhe jep hapësirë për pyetje nga pjesëmarrësit.

z. Arton Kajtazi, parashtrori pyetjet si në vijim;

-Sa hyrje do të ketë Zona Industriale?

z. Leutrim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sqarim parafolësit, theksoi;

-Për arsye se parcelat janë në kontest gjyqësor, deri sa të fitohet pronësia mbeten tri hyrje momentale.

z. Arton Kajtazi, parashtrori pyetjen tjetër;

-Si do të sistemohen sipërfaqet e parcelave për bizneset?

-Veçanërisht industria e lehtë?

znj. Valesa Jahmurati, u përgjigj;

-2500m²-10.000 m² janë standardet të cilat mund të kalohen, ndësa për industrinë e lehtë mbi 2500 m².

Si përfundim, **z. Leutrim Krasniqi**, potencoi meqenëse nuk ka të pranishëm tjerë që kanë kërkuar fjalën, falënderoj të gjithëve për prezencën dhe për kontributin e dhënë në këtë proces. Takimin po e përmbyllim. Gjithë të mirat!

Takimi përfundoi në ora 15:48.

Procesverbalin e mbajti,

Blerina Zeka

Podujevë,
22/03/2024





